

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegjii i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Valdete Daka, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve Nj. H. dhe M. H., që të dy nga komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në bashkëkryerje nga neni 317 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK, duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve Nj. H. dhe M. H., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan – Dega në Viti, P.nr. 484/2012 datë 24.4.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr. 849/2015 datë 1.9.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 9 mars 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve Nj. H. dhe M. H., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan – Dega në Viti, P.nr. 484/2012 datë 24.4.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr. 849/2015 datë 1.9.2015.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjilan – Dega në Viti, P.nr. 484/2012 datë 24.4.2015, të dënuarit Nj. H. dhe M. H. janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në bashkëkryerje nga neni 317 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK dhe për këtë veprë janë gjykuar secili veç e veç me dënim me

burgim në kohëzgjatje prej nga 90 (nëntëdhjetë) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet me kusht që në afat prej 2 (dy) vite, mos të kryejnë vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi do të revokohet. Janë detyruar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dëmtuarit Xh. L., A. M. dhe R. B., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Ky aktgjykim është ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr. 849/2015 datë 1.9.2015, si në vijim:

“Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore Gjilan, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, P.nr. 484/2012 datë 24.4.2015, përkitazi me vendimin për dënimin ashtu që kolegji i kësaj gjykate të akuzuarve Nj. dhe M. H., për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare si bashkëkryerës nga neni 317 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK, u shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej nga 4 (katër) muaj, të cilin dënim të akuzuarit janë obliguar ta mbajnë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit”.

Kundër këtyre aktgjykimeve, mbrojtësit e të dënuarve Nj. H., avokat E. P. dhe të dënuarit M. H., avokat A. I., nga Vitia, kanë paraqitur kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim apo të ndryshohet ashtu që të dënuarit të lirohen nga akuza, njëkohësisht mbrojtësit e të dënuarve kanë propozuar që të shtyhet ekzekutimi i dënimit.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr. 17/2016 datë 29.1.2016, ka propozuar që të hedhen si të palejuara kërkesat e të gjykuarve për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesat ka gjetur se:

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk janë të bazuara.

Në kërkesat e tyre, mbrojtësit e të dënuarve pretendojnë se aktgjykimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si në vijim:

- se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë mbi bazën e pranimit të fajësisë të të dënuarve pa u bindur paraprakisht nëse të dënuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe që pranimi i tillë të jetë i vullnetshëm ndërsa nga ana tjetër pranimi i fajësisë nuk ka mbështetje në provat materiale të prezantuara nga Prokurori i Shtetit;

- se pavarësisht nga pranimi i fajësisë, gjykata ka qenë e detyruar që të analizoj të gjitha provat që gjenden në dosje të lëndë dhe kështu të vërtetoj të gjitha rrethanat e veprës penale dhe veprimet e të gjykuarve;

- është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarve për faktin se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar fakti se të dënuarit kanë kryer veprën penale e cila u vihet në barrë theksojnë se kanë qenë të përfshirë në ngjarjen që ka ndodhur mirëpo nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim inkriminuese;

- është shkelur dispozita e nenit 390 par. 1 të KPPK, sepse të dënuarit nuk janë njoftuar për seancën e kolegjit të apelit për çka gjykata ka qenë e detyruar meqë të dënuarve u është shqiptuar dënimi me burgim edhe pse i njëjti dënim u ishte kushtëzuar.

Kurse mbrojtësi i të dënuarit M. H., avokat A. I., aktgjykimet i kundërshton edhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 12 lidhur me nenin 370 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë për faktin se në të njëjtin nuk janë specifikuar veprimet konkrete inkriminuese të së cilit të dënuar gjë që e bënë dispozitivin të paqartë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale lidhur me dispozitivin e aktgjykimit nuk qëndrojnë për arsye se siç rezulton nga shkresat e çështjes dhe dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë i njëjti është i qartë dhe konkret në të janë specifikuar veprimet inkriminuese të dënuarve të cilat janë

përshkruar në dispozitiv respektivisht fyerjet dhe kërcënimet të cilat të dënuarit Nj. dhe M. H., së bashku me familjarët të tjerë u kishin drejtuar të dëmtuarve.

Po ashtu, as pretendimi lidhur me çështjen e pranimit të fajësisë nuk qëndron për faktin se siç rezulton nga shkresat e çështjes dhe procesverbali mbi shqyrtimin gjyqësor i datës 21.4.2015 si dhe procesverbali i datës 23.4.2015, të dënuarit kanë pranuar fajësinë për çdo pikë të aktakuzës. Nga të njëjtat procesverbale rezulton se të dënuarit në mënyrë të qartë janë udhëzuar mbi të drejtën e tyre për të angazhuar mbrojtës si dhe përgjigjja e të dënuarve se në këtë çështje do të mbrohen vetë si dhe konstatimi se kanë kuptuar aktakuzën dhe pranimi i fajësisë është bërë në përputhje të plotë me ligjin meqë që të dy të dënuarit janë deklaruar se kanë kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, duke mos kundërshtuar përshkrimin faktik të veprës penale e cila të dënuarve u vihet në barrë e as cilësimin juridik. Për këtë arsye, gjykata e shkallës së parë duke gjetur se janë plotësuar kushtet nga neni 315 të KPK, (248 par. 4 të Kodit të aplikueshëm të Procedurës Penale), nuk ka administruar provat por shqyrtimin e vazhduar me fjalën përfundimtare në harmoni me dispozitën e nenit 359 par. 5 të KPPK.

Duke pasur parasysh se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë mbi bazën e pranimit të fajësisë siç edhe u cek më lartë, gjykata nuk ka detyrim ligjor të administroj provat e as që të jep arsyet për faktet vendimtare, meqë në rastin konkret pranimi i fajësisë plotësisht gjen mbështetje në provat e ofruara nga Prokurori, të cilat nga të dënuarit asnjëherë gjatë procedurës nuk janë kontestuar, madje nuk është ushtruar as ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Sipas dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, parashikohet se kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, njoftimi për seancën e kolegjit të apelit i dërgohet Prokurorit kompetent të Shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij. Duke pasur parasysh se në rastin konkret të dënuarve gjykata e shkallës së parë u ka shqiptuar dënimin me kusht, nuk qëndron detyrimi i gjykatës që në kuptim të kësaj dispozite të njëjtit të njoftohen për seancën e kolegjit, prandaj pretendimi qartazi del i pabazuar.

Nga arsyet e lartcekura, kjo Gjykatë vlerëson se konkludimet e gjykatave të instancës më të ulët përkitazi me fajësinë e të dënuarve dhe cilësimin juridik të veprës penale siç është

paraqitur në arsyetimin e aktgjykimeve në fjalë janë të drejta dhe të ligjshme të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë.

Përkitazi me shkeljen e ligjit penal, mbrojtësit e të dënuarve potencojnë se edhe pse të dënuarit kanë qenë të përfshirë në ngjarjen që ka ndodhur mirëpo nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim inkriminuese dhe se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar fajësia e tyre.

Vlen të theksohet se Konform dispozitës së nenit 432 të KPPK kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 1 të KPPK dhe për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla, kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

Mirëpo, lidhur me pretendimet nga kërkesa se është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, vlen të theksohet se shkeljet e ligjit penal për të cilat mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, janë të përcaktuara në dispozitën e nenit 385 të KPPK e cila dispozitë në mënyrë taksative numëron rastet kur një vendim gjyqësor konsiderohet se është përfshirë me këto shkelje, ndërsa në kërkesë nuk është precizuar se për të cilat shkelje bëhet fjalë.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve janë refuzuar si të pabazuara meqë kjo Gjykatë konstaton se aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelen e ligjit penal në dëm të dënuarve.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Pml.nr. 22/2016, më 9 mars 2016

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Avdi Dinaj